



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3017/Prot.  
2

Tiranë, më 09.10.2023

V E N D I M

Nr. 62, datë 09.10.2023

**“PËR MIRATIMIN E KOSTOS SË STUDIMEVE NË PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME”, QË OFROHET NGA FAKULTETI I MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, pika 3 dhe 49; në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 51; në Vendimin e KM-së nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, pika 6; në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 61, datë 02.10.2023 “Për përcaktimin e kostos së studimeve për programin e integruar të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në UMT”; në Vendimin Qarkullues të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 5, datë 04.10.2023 “Për miratimin e propozimit të Administratorit të Fakultetit të Mjekësisë me nr. 2590 prot., datë 04.10.2023 “Kërkesë për Propozim”, në Relacionin e Grupit të Punës nr. 2693/7 prot., datë 04.10.2023 “Mbi një shtesë në Relacionin e Grupit të punës nr. 2693/3 prot., datë 27.09.2023 “Mbi analizën e kostos për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; në Vendimin Qarkullues të Rektoratit të UMT-së nr. 17, datë 05.10.2023 “Për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit “Mjekësi e përgjithshme” që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin të Mjekësisë, Tiranë”, si dhe në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 109, datë 06.10.2023, për “Miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në mbledhjen e datës 09.10.2023, Bordi i Administrimit të UMT-së,

V E N D O S I:


1. Të miratojë koston e studimeve të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, mbështetur në Vendimin Qarkullues nr. 109, datë 16.10.2023 të Senatit Akademik të UMT-së, në tabelën e mëposhtme:

	<b>Të dhënat për Fakultetin e Mjekësisë</b>	<b>Të dhënat për programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme"</b>
Pesha Specifike	<b>100%</b>	<b>51.8%</b>
<b>Kosto direkte</b>		
Fondi personeli	747,170,330	387,034,231
Shpenzime për bursa	83,700,000	76,400,000
<b>Total kosto direkte</b>	<b>830,870,330</b>	<b>463,434,231</b>
<b>Kosto indirekte</b>		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave*	83,087,033	38,703,423
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave*	124,630,550	58,055,135
<b>Total kosto indirekte</b>	<b>1,038,587,913</b>	<b>96,758,558</b>
<b>Total kosto (direkte + indirekte)</b>	<b>1,869,458,243</b>	<b>560,192,789</b>
Numri i kuotave të certifikuara të studenteve MP viti akademik 23-24		2,250
Kosto për student		<b>248,975</b>

2. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**MONIKA FIDA**

**ANIS THODHORJANI**





**VERA OSTRENI**

**ALTINA XHAFERI**



**ALBANA GJINOPULLI**

**ENDRIT YZEIRAJ**



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3017/16 Prot.

Tiranë, më 11.10.2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 63, datë 11.10.2023

**PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 62, DATË 09.10.2023 "PËR MIRATIMIN E KOSTOS SË STUDIMEVE NË PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MJEKËSI E PËRGJITHSHME", QË OFROHET NGA FAKULTETI I MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, neni 122; në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49; në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 51, pasi u konstatua gabim në shkrimin e datës së Vendimit nr. 109, datë 06.10.2023 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit të UMT-së,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 62, datë 09.10.2023 "Për miratimin e kostos së studimeve në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "mjekësi e përgjithshme", që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë" data "16.10.2023" bëhet "06.10.2023".
2. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ